



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primjelo/Prodato Received/Delivery	15. 03. 2021	viti / god year	1
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SP/MSHOK	1155/2021		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.49/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari -anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.49/2021 të datës 01.02.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga "Mulla Idrizi" Objekti Banesor-Katana 1, banesa kati II, nr.2, Komuna Gjilan, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.03.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.49/2021 të datës 01.02.2021, të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës, më datë 01.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 412/2021 e regjistruar me numër A.nr.49/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës materiale për periudhën Tetor-Nëntor-Dhjetor 2020 dhe Janar 2021, sipas pakos emergjente COVID-19.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.02.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te ankuesit tek Policia e Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 04.03.2021 ka pranua nga Policia e Kosovës, përgjigjen në kërkesë me numër protokoli: 997/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli 412/2021 të datës 01.02.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për



Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; kopjen identifikues të kartelës së policisë së ankuesit; Lista e pagës së ankuesit me shtesën e paguar nga pakoja emergjente covid-19; Lista e vijueshmërisë dhe hyrje-daljeve në punë e datës 31.01.2021 për periudhën kohore 01 nëntor 2020 deri më 31 janar 2021; E-mailin e datës 31.01.2021 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 01.02.2021 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 02.02.2021 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 31.01.2021 dërguar në KPMSHCK me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 03.02.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 04.03.2021; E-mailin e datës 18.02.2021 me korrespondencën e bashkangjitur; Kontratën e punës së ankuesit me numër reference 07/1-01A/0661 e datës 04.08.2014; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Radio komunikues" në Policinë e Kosovës; Kontratën e datës 18.12.2003; Shkresën e datës 04.09.2015; E-mailin e datës 24.02.2021 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 24.02.2021 me titull Lista e kërkuar nga DPR për muajin Tetor 2020 dhe korrespondencën e bashkangjitur; Lista e evidentuar se Bilanci-kompensim për periudhën kohore prej 14.07.2020 deri më 17.02.2021; Orari i punës për stafin civil në Policinë e Kosovës për periudhën kohore prej muajit mars 2020 deri në muajin janar 2021; Listën e pagave të ankuesit për tërë vitin 2020; Listën e pagës së ankuesit për muajin janar të vitit 2021; Listën e pagave të ankuesit për muajt Shtator, tetor, Nëntor, Dhjetor 2020; E-mailin e datës 26.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës, respektivisht Kontratën e punës me numër reference: 07/1-01A/0661 për kohë të pacaktuar të datës 04.08.2014 të ankuesit, ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës "Radio komunikues" në kuadër të Policisë së Kosovës-Njësia: Stacioni Policor Gjilan-Sektori i Operativës-Qendra e Komunikimit, Drejtoria Rajonale e Gjilanit, Drejtoria Rajonale Prishtinë dhe i njëjti sipas kontratës së punës kryen këto detyra të punës: *I pranon dhe i shpërndan informata hyrëse dhe dalëse nga zyra e komunikimit. Kujdeset për regjistrimin, sisteminin dhe shpërndarjen e informatave. Mban shënime dhe kujdeset për veprimet e patrullave. Pranon të gjitha thirrjet dhe i shpërndan informatat. Angazhimi për mbajtjen e komunikimit të nevojshëm me Departamentit/Drejtoritë dhe njësitë tjera të Policisë së Kosovës. Mban kontakt me institucionet e ndryshme brenda territorit që kujdeset stacioni apo njësia. Kujdeset për sigurimin e të dhënave të kërkuara për njësitë patrulluese në terren. Bënë verifikimin e personave të dyshuar në listat përkatëse. Bënë verifikimin e veturave (për regjistrim, vjedhje, aksident etj). Kryen edhe punë tjera që ja përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe e të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit.*

Lidhur me pranueshmerinë e ankesës, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: *"paragrafi 3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë: paragrafi 6. Nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"* dhe si rrjedhojë duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit, Kolegji ka konstatuar se

pozita "radio komunikues" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, respektivisht ankuesi \_\_\_\_\_ nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesi ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.49/2021 e datës 01.02.2021 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ-teknik dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës, dhe sipas 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtarët publik me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.49/2021

**Flakron Gashi**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref Shabani**



Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Policisë së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;